



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me neni 17 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë,-----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet nga **Visar Sokol Basha** në pjesën e parcelës kadastrale **P-72116046-012110-0**, e cila i është dhënë në shfrytëzim me Vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-016-51843, të datës 30.08.2024 dhe sipas kontratës 01-Nr-016-55172 të datës 18.09.2024 për ndërtimin e objektit afarist-banesore, në këtë përbërje;

- 1.1. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.2. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.3. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.4. -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës
- 1.5. -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni janë që të bëjnë ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste që i takojnë Komunës në objektin që do të ndërtohet nga investitor i cekur më lart në pjesën e parcelës te cekur në nenin 1 të këtij vendim dhe pas arritjes së marrëveshjes përfundimtare, të hartojnë marrëveshjen dhe t'i rekomandojnë Kryetarit të Komunës që marrëveshjen ta miraton në Kuvendin e Komunës së Suharekës dhe tek atëherë nënshkruhet nga Kryetari i Komunës me palën investuese.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI